



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 720 Prot.

Tiranë, më datë 13.07.2020

VENDIM

Nr. 204, datë 02.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit mbi verifikimin në terren dhe konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për gjetjet arkeologjike rastësore (Terma Romake) në njësinë Administrative Rrasë, Bashkia Belsh, raportuar nga Bashkia Belsh dhe realizuar nga specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;
2. Të kryhet gërmimi arkeologjik sipas konceptit të gërmimit arkeologjik të depozituar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës;
3. Gjetjet arkeologjike të dala si rezultat i gërmimit arkeologjik të shpëtimit të depozitohen paraprakisht në fondet e Bashkisë Belsh deri në përcaktimin e destinacionit final të tyre;
4. Në përfundim të procesit gjetjet arkeologjike të regjistrohen pranë Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elyza MARGARITI

